

25 vjetori i KSSH 24.06.2016

Fjalimi i Enisa Salimovic, ITUC/PERC SEE Office

I dashur president z. Kol Nikollaj,

Te dashur te dashur zonja dhe zoterinj, te ftuar

Te dashur sindikaliste,

Po ju drejtohem ne emer te Konfederates se sindikatave nderkombetare (ITUC) si organizata me e madhe sindikaliste qe perfaqeson 180 milion punetore ne 162 vende dhe territore dhe ka 333 anetaresime, perfshire dhe KSSH ne Shqiperi.

Ne mirepresim organizaten tuaj dhe 160.000 sindikalistet tuaj te cilet sot festojne 25 vjetorin. Ne besojme qe nuk ka qene e lehte te organizoni sindikata ne ato kohera, ne vecanti pas regjimit te kaluar, por lidhja e sindikatave gjithmone ka qene nje sfide. Dhe organizata juaj qe atehere, per 25 vite tashme, ka qene e sukseshme ne permbushjen e ketyre sfidave. Ne do te donim te pergezoni organizaten tuaj per veprimet dhe aktivitetet e ndryshme qe ju keni ndjekur per vite me radhe.

Organizata juaj merr pjese ne menyre aktive ne shume aktivite, organe dhe struktura te ITUC dhe PERC ne te cilen sindikatat diskutojne dhe krijojne strategji ne shume ceshtje ne lidhje me interesat e puntoreve dhe anetareve te tyre. Bashkepunimi dhe potenciali per t'ju bashkuar politikave dhe veprimeve te sindikatave ne te gjitha nivelet jane shume me te rendesishme ne kohet e krizave, ndryshime te thella dhe sfidat globale nderkohe ndarja mund te dobesonte pozicionin e tyre e te limitonte kapacitetin per zhvillimin e drejte dhe te qendrueshem te shoqerise demokratike ne interes te njerezve punetore.

Tani, qe vendit tuaj i eshte dhene statusi i nje vendi kandidat per BE, ka shume per te bere. Ne po i inkurajojme sindikatat shqiptare te nderrmarrin rolin aktiv ne procesin hyres te BE dhe harmnonizimin e legjislacionit kombetar me standartet Europiane. Ne dime qe reforma per ligjin e punes po ecin ne Shqiperi, po ashtu dhe reforma e sistemit te pensioneve, dhe keto reforma zakonisht jane shume te veshtira. Por varet nga sindikatat ne Shqiperi qe te jene aktive sa me shume te jete e mundur ne te gjitha proceset e berjes se reformave ne rregullimin e standarteve te punes, te mbrojtur ne konventat dhe rekomandimet e ILOs, standartet e BE, keshtuqe ato te pershtaten tek njerezit puntore, te gjitha grupet vullnetare, grate, te papunet dhe te varferit. Ne duam pune te denje per te gjithë,

ne duam te drejta baze (themelore) te punetoreve qe te respektohen, pa asnje perjashtim.

Ju e dini qe dialogu social eshte themelimi me i mire per ndertimin e konsensusit te forte per reformat, ne vecanti nese ne duam qe keto reforma te kontribojne ne zhvillimin me te qendrueshem dhe efektiv. Rruga drejt anetaresimit ne BE hap mundesi te rralla per ndikimin e politikes e sindikatave, por ato duhet te jene mirepergatitura dhe fokusuar ne dimensionet e rendesishme dhe strategjike qe te bejne menaxhimin me te mire te situates.

Ne ju urojme suksese ne punet tuaja ne te ardhmen qe duhen per zhvillimin e Shqiperise ne favor te punetoreve ne vendin tuaj dhe rajon.

Sllogani per 25 vjetorin e KSSH eshte: Te forte sebashku, te forte ne Europe dhe gjithashtu sindikatat ne Shqiperi duhet te jene sebashku ne kete udhetim, duhet te zhvillojne frymen pozitive te bashkimit sindikal, pasi vetem te bashkuar mund te jemi me te forte.

Me solidaritet

Enisa Salimovic.